



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VII

Sesioni pranveror

Komisioni për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes

Mbledhja nr.10

Prishtinë, më 13.08. 2020, në orën 09:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ÇËSHTJE TË SIGURISË DHE MBROJTJES

Në mbledhje morën pjesë: Fatmire Kollçaku, kryetare e Komisionit, Bekë Berisha, nënkryetar i parë, Slavko Simiq, Nënkyetar i dytë, Rexhep Selimi, Mefail Bajqinovci, Ilir Tasholli, Hetem Baxhaku, Elmi Reçica, Ganimete Musliu, Rasim Demiri, anëtarë.

Mungoi: Haxhi Shala, Slavko Simiq.

Përfaqësuesit e Ministrisë së Mbrojtjes: Gjenerallejtënat Rrahman Rama-Komandant i FSK-së, Ali Bajqinovci, Berat Shala, Manushaqe Nura

Nga stafi mbështetës i komisionit: Nur Çeku dhe Zarë Aliu.

Mbledhjen e kryesoi, Fatmire Kollçaku, kryetare e Komisionit

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

Raportimi i Komandantit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, Gjenerallejtënant Rrahman Rama

Kryetari i komisionit konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

Kryetarja, fillimisht falënderoi z.Rrahman Rama për pranimin e ftesës dhe ardhjen në Komision, duke shtuar që arsyeja pse janë ftuar në Komision është lidhur me shqetësimet e situatës së sigurisë në vend, lidhur me situatën e krijuar në Karaçevë të Kamenicës, ku janë shfaqur disa persona të armatosur. Për këtë arsye dëshirojmë të dimë kush janë ata, pasi e konsiderojmë si provokim të hapur.

Gjenerallejtnant Rrahman Rama-Komandant i FSK-së, fillimisht theksoi se pavarësisht incidentit që ka ndodhur në Karaçevë të Kamenicës me datë 7 gusht 2020, situata e sigurisë është e mirë dhe të gjitha institucionet janë të koordinuara. S ai përket pandemisë, në kuadër të FSK-së, situata është brenda kontrollit, aktualisht janë shtatë pjesëtar me virus, 29 janë në vetizolim. FSK-ja ka ofruar të gjitha kapacitete në shërbim të institucioneve dhe autoriteteve civile.

Ndërsa s ai përket incidentin kufitar, është parë që forcat e armatosura të Serbisë kanë hyrë në territorin e Kosovës me datë 07.08.2020 në fshatin Karaçevë e ulët. Nga pamjet duket të jenë 11 pjesëtar të uniformuar ku nëntë prej tyre kanë pasur uniformë që janë të njëjtë me atë të xhandarmërisë serbe ndërsa nuk është arritur të identifikohen ushtar të kombësive të tjera të KFOR-it. Tutje theksoi se kanë komunikuar me KFOR-in lidhur me këtë çështje. Gjithashtu theksoi se në atë pjesë zhvillohen disa aktivitete të paligjshme, andaj shteti i Kosovë duhet të ndërmarr masa, në mënyrë që të zgjidhen këto çështje. Në atë pjesë nuk paguajnë taksa, rrymë ndërsa bëhet kontrabandë e gjërave të ndryshme, ndërsa referuar incidentit në pikën kufitare, theksoi se këto çështje duhet të rregullohen edhe nga aspekti diplomatik, duke shtuar që FSK-ja zbaton urdhra, ndërsa patrullimin e kufijve në shtete demokratike e bënë policia dhe jo ushtria. Po ashtu theksoi se një defilim i forcave serbe, nuk është i rastësishëm, ecja e tyre, armatimi që mbanin, tregon që ka qenë i qëllimshëm dhe ka krijuar pasiguri edhe tek qytetarët. Po ashtu shtoi se FSK është në proces të tranzicionit për krijimin e kapaciteteve të veta, në mënyrë që të ketë kapacitet të angazhohet. Ndërsa sa i përket buxhetit, theksoi se këtë vit kanë më pak buxhet rreth pesëmbëdhjetë milion euro, duke marrë parasysh prioritetin që duhet të ketë Qeveria, është e rëndësishme që në planin dhjetëvjeçarë të zhvillohet plani i paraparë, pasi për të ofruar një siguri duhet të kemi kushte të sigurta për ushtarët.

Ganimete Musliu, duke iu referuar ndërhyrjes së forcave serbe në kufij në fshatin Karaçevë, shtoi se e

ka parë me shqetësim. Ndërsa sa i përket buxhetit, theksoi se në Komision do të ketë unanimitet që të mbështetet FSK-ja. Ndërsa sa i përket institucioneve, kërkoi që të jenë më reaguese dhe të përgjegjshme, në raste sikur ndodhi në Karaçevë.

Ilir Tasholli, falënderoi Komandantin për raportimin, duke shtuar se nga ky raportim kanë një pasqyrë të qartë dhe si anëtar i Komisionit do të ofroj mbështetjen.

Mefail Bajqinovci, duke qenë se ka vizituar fshatin Karaçevë, theksoi se edhe nga banoret e asaj pjese është përmendur kontrabanda, duke shtuar që persona të caktuar kanë lidhje me struktura ushtarake. Duke shtuar që është e nevojshme që të dihet në bazë të çfarë marrëveshje bëhet patrullimi i përbashkët i vijës kufitare.

Rexhep Selimi, shtroi pyetjet si në vijim: Si qëndron bashkëpunimi ndërinstitutional, me policinë, doganat dhe AKI-në? Si është bashkëpunimi me KFOR-in? Sa është duke u zbatuar Neni 4 i ligjit të FSK-së?

Gjenerallejtnant Rrahman Rama-Komandant i FSK-së, falënderoi për përkrahjen e ofruar nga ana e deputetëve, ndërsa s ai përket proces të transformimit theksoi se janë në bashkëpunim e Shtete e Bashkuara të Amerikës dhe janë bërë kërkesa për pajisje me elemente të reja.

Gjithashtu theksoi se janë duke punuar në *Cyber Defence Program*, i cili është në fazën e parë ku një pjesë mbështet nga SHBA-ja ndërsa një pjesë më e vogël nga Qeveria e Kosovës. Gjithashtu theksoi që sistemi i komunikimit nuk është shumë i sigurt, për këtë arsye e vlerësoi si të nevojshme trajnimi në këtë fushë, po ashtu theksi se FSK-së i duhet përkrahja e Kuvendit. Bashkëpunimi me KFOR-in është shumë i mirë, ndërsa incidentin që ka ndodhur në Karaçevë e konsideroi si pa përgjegjshmëri e atyre që e monitorojnë këtë pjesë, pasi vijat kufitare janë të qarta. Ndërsa s ai përket zbatimit të Nenit 4 të Ligji të FSK-së, theksoi se FSK-ja është në ndërtim të kapaciteteve, ndërsa theksoi se janë disa gjëra që duhet të qartësohen në nivelin politik.

Bekë Berisha, shtroi pyetjet si në vijim: A ka policia e Kosovës ndalesa që të patrulloj në pjesën e Karaçevës? A zhvillohen aktivitete të paligjshme në atë pjesë?

Gjenerallejtënant Rrahman Rama-Komandant i FSK-së, theksoi e vija kufitare në atë pjesë është e caktuara, ndërsa problemi në rrugën që është ndërtuar nga KFOR-i, që është një bypass, shtoi se është diskutuar që edhe FSK të ndërtoj atë rrugë. Ndërsa sa i përket patrullimit të përbashkët mes Policisë së Kosovës dhe KFOR-it, theksoi se është çështje e policisë pse nuk kanë pranuar të bëjnë një patrullim të përbashkët, pasi është dashur më larg se pika kufitare të patrullojnë. Ndërsa a i përket aktiviteteve të paligjshme, theksoi e janë kazino dhe biznese që nuk paguajnë as taksa Qeverisë s Kosovës.

Elmi Reçica, falënderoi për raportimin Komandantin e FSK-së, duke shtuar që problemet që janë shfaqur, duhet të zgjidhen nga pjesa politike, për këtë arsye e konsideroi të nevojshëm takimin edhe me udhëheqësit e Ministrisë së Punëve të Brendshme, Drejtorin e Policisë si dhe Ministrin e Jashtëm. Tutje shtroi pyetjen. Cili është dallimi mes patrullave të përbashkëta dhe sinkronizimit? A është përgjegjës Boundstill për këtë pjesë? Ndërsa kërkoi që lidhur me marrëveshjen e vitit 2001 që është nënshkruar mes KFOR-it dhe forcave serbe, Kosova duhet të ketë qasje.

Gjenerallejtënant Rrahman Rama-Komandant i FSK-së, theksoi se patrullimi dhe sinkronizimi janë dy çështje të ndara dhe duhet të përcaktohet rrezikshmëria e palëve. Por në rastin konkret në Karaçevë, nuk duket të ketë pasur as patrullim të përbashkët e as sinkronizim.

Elmi Reçica, si është komunikimi strategjik mes institucioneve?

Gjenerallejtënant Rrahman Rama-Komandant i FSK-së, thekso se komunikimi strategjik është i nevojshëm, por në disa raste edhe mungon, siç ka ndodhur me rastin e Karaçevës ku nuk ka pasur takime mes institucioneve.

Rexhep Selimi, duke iu referuar deklaratës për media të KFOR-it, lidhur me rastin në Karaçevë, theksohet se "për këtë çështje janë hapur procedura të hetimit të brendshëm", për këtë arsye kërkoi që në të ardhmen do duhet të kemi informacion. Gjithashtu shprehi që institucionet sigurisë është dashur të mblidhen për këtë çështje.

Ganimete Musliu, shtroi pyetjen si në vijim. A duhet të paralajmëroj KFOR-i patrullimin?

Gjenerallejtënant Rrahman Rama-Komandant i FSK-së, sa i përket kontrolleve kufitare, nuk është e nevojshme të bëhet, ndërsa sa i përket komunikimeve të përbashkëta, theksoi e kjo do të ishte mirë të bëhet, pasi kjo i kontribuon bashkëpunimit.

Kryetarja, falënderoi Komandantin e FSK-së për raportimin. Ndërsa njoftoi që sa i përket raportit me tre emrat për përzgjedhjen e Komisionerit të Agjencisë për Informim dhe Privatësi, do të futet si pikë shtesë në seancën plenare, ndërsa propozoi që të specifikohet se në sa raunde do të shkohet në seancë. Gjithashtu theksoi se në Memorandumin me Ambasadën Britaneze, theksohet që të respektohet notimi që është bërë gjatë procesit.

Komisioni u dakordua që procesi i përzgjedhjes së kandidatëve për Komisioner të Agjencisë për Informim dhe Privatësi, të bëhet përmes dy raundeve

Me këtë pikë të rendit të ditës e konsideroi mbledhjen e mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 10:15.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit

Kryetare e komisionit,

Fatmire Kollçaku